



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo - territoriale

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.2.2026, ora 14:30

Drejton mbledhjen:

Arbjan Mazniku – Bashkëkryetar i Komisionit

Luçiano Boçi – Bashkëkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 11.11.2025.
2. Shqyrtimi i projektvendimit për caktimin e sekretarit të Komisionit.
3. Shqyrtimi i projektvendimit për miratimin e emrave të ekspertëve pranë komisionit.
4. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Arbjan Mazniku, Luçiano Boçi, Blendi Klosi, Damian Gjikhuri, Ermal Pacaj, Romina Kuko, Ermal Elezi, Klevis Jahaj, Jorida Tabaku, Ramadan Likaj, Xhelal Mziu, Enno Bozdo, Edmond Haxhinasto, Etleva Budini, Agron Malaj, Vangjel Dule, Etleva Budini dhe Artan Luku.

Mungojnë:

Marjana Koçeku dhe Bledion Nallbati.

HAPET MBLEDHJA

Arbjan Mazniku - I nderuar bashkëkryetar,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Së pari, dua t'ju falënderoj që jeni të pranishëm, por edhe për faktin që jemi rimbledhur të gjithë bashkë, bashkë me opozitën, për të vijuar me shpresë dhe besim punën për një nga reformat më të rëndësishme që vendi ka përpara.

Besoj se, edhe në vijim të diskutimit që kemi bërë, ka një dakordësi të qenësishme për faktin që një reformë e tillë, është një reformë që prek mënyrën se si u ofrohen shërbimet qytetarëve dhe besoj se jemi dakord të gjitha palët që kjo është një reformë e domosdoshme për vendin. Sigurisht, ky është një komision që do të vijojë të ketë diskutime dhe debate, të cilat janë të shëndetshme për pikëvështrimin dhe mënyrë se si duhet të ndodhë reforma, për elementet që duhet të përmbajë, por është tashmë një hap i shëndetshëm fakti që kemi dakordësi për nevojën që vendi ka për të pasur një reformë.

Debati është i shëndetshëm, i dobishëm, sjell eventualisht zgjidhje më të dobishme për vendin dhe për qytetarët, pra është një hap i shëndetshëm përpara. Është e rëndësishme që ne ta fillojmë këtë proces siç duhet dhe të kalojmë nga dakordësia për të punuar në punën që duhet bërë. Në fakt, kjo duhet të jetë tema e përgjithshme e kësaj mbledhjeje.

Sot në agjendë, ashtu siç është lajmëruar, kemi: miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 11 nëntor, që është mbledhja e parë që bëme të gjithë bashkë, mbledhja formale. Nëse nuk ka ndonjë koment për këtë, procesverbali ka ardhur me *email*, e konsiderojmë të miratuar.

Pika e dytë është shqyrtimi i vendimit për caktimin e sekretarit të komisionit. Sipas Rregullores së Kuvendit komisioni duhet të ketë një sekretar, i cili ka seri detyrash operationale në mënyrën se si funksionon komisioni, që kanë të bëjnë me mbledhjet, rendin e ditës, procesverbalet. Propozimi i Partisë Socialiste është që rolin e sekretarit të komisionit ta marrë deputeti Ermal Pacaj, i cili ka një eksperiencë në pushtetin vendor.

A ka ndonjë koment për këtë pikë të rendit të ditës.

Luçiano Boçi - Faleminderit!

Të nderuar deputetë, ju përshëndes dhe ju siguroj që, edhe ne kemi të njëjtën qasje për rëndësinë e madhe që ka Komisioni i Reformës Territoriale. Që të mos bëjmë rolin e atij që mbyll sytë dhe veshët njëkohësisht, marrëdhëniet në Parlament midis mazhorancës dhe opozitës nuk janë në normalitet, janë marrëdhënie të tensionuara, për shkak të mënyrës së sjelljes së mazhorancës, që përgjatë gjithë kësaj kohe ka tentuar kufizimin e jetës parlamentare të opozitës dhe të të drejtave të saj.

Prej kohësh ky Parlament nuk kalon në miratim asnjë komision hetimor, prej kohësh nuk ka asnjë mocion me debat, shmangen interpelancat apo seancat dëgjimore me anëtarë të Këshillit të Ministrave. Për pjesën tonë, duke ditur këtë rëndësi që thashë, nuk ka qenë

asnjëherë e lehtë që ne të vazhdojmë të jemi në një komision të posaçëm, sepse qartazi ne vijmë nga një qëndrim, të përcaktuar tashmë, jo vetëm në betejat që bëjmë në Parlament, por edhe betejat që bëjmë jashtë Parlamentit.

Ne vijmë pas disa protestash, që nuk janë thjesht protesta politike, janë protesta qytetare dhe, ndërmjet të tjerave, kanë të bëjnë me mënyrën se si sillet Parlamenti ndaj ligjeve dhe detyrimeve që ka ndaj qytetarëve, pse jo ndaj drejtësisë dhe vetë shtetit. Të mos harrojmë, është ky Parlament që ka bllokuar Këshillin e Mandateve dhe Imuniteteve, i cili është edhe në paritet të plotë, megjithëse anëtarët e Partisë Demokratike në atë Këshill kanë kërkuar mbledhjen e tij për të autorizuar Kuvendin që të përcaktojë çështjen e imunitetit të zëvendëskryeministres.

Vijmë nga një protestë, ku njerëzit tanë që marrin pjesë shprehin revoltën e tyre, arrestohen, dhunohen, përplasen me forcat e rendit, madje forcat e rendit nuk kursejnë as “imunitetin” në thonjëza, se nuk është ndonjë imunitet i madh, i deputetit, dhe shfaqen me një egërsi të paprecedentë, ndërkohë që mbrojtja nga krahu tjetër ndërkallet në procedura ligjore, në tentativa për të ndryshuar ligjin kur gjërat janë të thjeshta dhe të qarta.

Ky Parlament nuk duhet të jetë në një oaz sikur funksionon, sepse në pjesën më të madhe të tij nuk funksionon. Ne jemi deputetë të së njëjtës hapësirë, jo të hapësirave autonome. E them këtë për të paralajmëruar atë pjesë, që ne nuk do të donim të ndodhte në këtë komision. Nëse jemi ulur këtu, jemi ulur me bindjen që i shërbejmë qytetarit dhe Shqipërisë, sepse ka të bëjë me një problem shumë të ndjeshëm me qeverisjen, me territorin, me zhvillimin ekonomik dhe me shërbimet që duhet të ofrohen, por ne duhet të jemi të bindur që nuk ka një paravendosje, një paracaktim të produktit të këtij komisioni.

Ne këtu bëjmë xhiron e botës apo të Shqipërisë sa për spektakël, meqenëse jemi edhe këtu në paritet, dhe në fund fare nga mënga ju na nxirrni variantin, për të cilin gabimisht apo fatkeqësisht keni pasur prononcime të niveleve të ndryshme: për numrin e bashkive, për ndarjen e territorit apo për krijimin e institucioneve të tjera. Duke iu përmbajtur logjikës politike, por edhe parlamentare, ne do të donim që komisioni që është ngritur me konsensus, që ka paritet, duhet të ketë patjetër një produkt të vetin. Kjo do të thotë: po, ne do të punojmë me ekspertët, do të punojmë për atë qëllim të rëndësishëm, por në fund fare ne duhet të dalim me një produkt të dakordësuar në bazë të paritetit që kemi vendosur.

Nëse rruga jonë kalon pjesërisht nëpërmjet konsensusit, ne votojmë raporte të caktuara, sepse është domosdoshmëri që të ecë përpara komisioni, apo vendime të caktuara që kërkojnë konsensus dhe në fund fare del me variant të personalizuar politik, atëherë, çfarë kuptimi ka komisioni? Për këtë duhet të bimë parimisht dakord. Kjo është baza e nisjes së këtij komisioni. Po, ne duhet të kemi një produkt të përbashkët.

Nëse ecim me idenë që çfarëdo të themi ne nuk konsiderohet, nuk merret si pjesë e vendimmarrjes, si pjesë e propozimeve që faktohen në raportin final apo daljen finale, atëherë ne jemi në një rrugëtim krejtësisht hipokrit dhe formal. A kemi siguri ne për këtë? Jo, nuk kemi siguri, sepse unë e parashtrova mënyrën e sjelljes së mazhorancës në shumë momente pikante, në shumë momente votuese, në shumë kërkesa që ajo ka drejtuar dhe drejton, që bëhet vesh i shurdhër dhe sy qorr, ku iu referova edhe Këshillit të Mandateve.

Prandaj, të nderuar deputetë, anëtarë të këtij komisioni, unë mendoj që, para se të nisim këtë pjesën e këtij rrugëtimi shumë të rëndësishëm, të mirëkuptuar nga shqiptarët, të kërkuar prej tyre, ne duhet të vendosim standardit parlamentar dhe politik të një komisioni, që është në paritet. Ne duhet të kemi një produkt konsensual, të dakordësuar nga të dyja palët. Nëse nuk ka produkt, atëherë është mungesë e gatishmërisë suaj, por edhe e sonës për të pranuar variantet, por varianti të jetë i fuzionuar, jo një variant totalisht me ngjyrën e partisë suaj apo një variant me ngjyrën e partisë demokratike.

Kjo është kërkesa ime thelbësore, kryesore që, në fakt, ndërton bazat e një pune, që kërkon të ecë në atë sukses që sot është i domosdoshëm, që ka ardhur për shkak të dështimit të reformës së vitit 2015, për ato pasoja që ka sjellë në qeverisje, në shërbimet ndaj qytetarit, në kompetenca, në autonominë e pushtetit lokal apo pasojat e tjera. Ejani ta vendosim këtë bazë politike të rëndësishme dhe të vazhdojmë punën e pritur nga ky komision.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku - Faleminderit!

Unë kam 2-3 komente për gjërat që sapo thatë, veçanërisht në raport me punën e komisionit të reformës.

Së pari, unë besoj se është pozicioni i qartë i mazhorancës, që të ketë një komision, i cili idealisht të dalë me një pozicion. Ka pasur mjaftueshëm shprehje të vullnetit të mazhorancës që, nëse është e mundur që kjo reformë të kalojë me unanimitet në Kuvend, do të ishte zgjidhja ideale e kërkuar. Unë besoj se ka tashmë prova të dhëna nga ana e mazhorancës në raport me këtë komision të mirëbesimit për një proces të tillë, duke filluar që nga kërkesa për bashkëkryesinë, te kërkesa për ndarjen në mënyrë të barabartë të anëtarëve të këtij komisioni, te kërkesa, që ishte shumë e natyrshme dhe e mirëpranuar nga ana e mazhorancës, që ne të thërrasim kongresin e autoriteteve vendore, si një partner në këtë komision, por edhe BE-në, por edhe aktorë të tjerë potencialë, si partnerë të punës së këtij komisioni, siç ishte së fundi, pas një mungese dymujore në komision, një kohë shumë e vyer që ky komision nuk e ka këtë luks, gjë që është shprehur në mënyrë të qartë që në mbledhjen e parë, që kemi një agjendë të ngjeshur pune, por me dakordësinë që, pavarësisht hapave, ne ta ndalonim pozicionin dhe të

riktheheshim në tavolinën e punës për të gjetur opsionin e një bashkëpunimi të mundshëm, të ndërgjegjshëm për faktin që kjo reformë do të ishte e shëndetshme dhe e mirë për vendin nëse do t'ia dalim ta kalojmë bashkërisht. Mirëbesimi i dhënë tashmë në mënyrë sistematike nga ana e mazhorancës, nuk mund dhe nuk duhet të jetë një mekanizëm për të bllokuar punën dhe për të mos e çuar përpara këtë reformë.

Ne kemi një dritare, dhe unë e them këtë jo vetëm për kolegët që janë këtu, por edhe për publikun që na ndjek, sepse kjo është një temë që ka tërhequr shumë interes, shumë specifike për këtë reformë. Kjo dritare lidhet me faktin që në vitin 2027 Shqipëria mbyll negociatat me BE-në dhe, sipas të gjitha gjasave, me vullnetin politik edhe të BE-së, në vitin 2029-2030 Shqipëria bëhet një vend anëtar, ku ne na duhet që në këtë periudhë të caktuar të kemi bashki dhe rajone të afta për të funksionuar, sërish e them, jo thjesht si struktura, që janë të afta për ofruar shërbim për qytetarët e tyre, por që janë të afta të tërheqin financime dhe mbështetje nga BE-ja për territorin e tyre, dhe ta ngrenë funksionimin përtej t punës komunale në qytet, por si struktura që tërheqin financime dhe projekte nga BE-ja për territorin e tyre. Kjo është një dritare që ne nuk duhet dhe nuk mund ta humbasim.

Është e rëndësishme që ne të kemi mundësinë ta kryejmë këtë reformë përpara zgjedhjeve të vitit 2027, me qëllim që të hyjmë me sistemin e ri në zgjedhjet e vitin 2027, ta përdorim dritaren 2731 si një përgatitje institucionale, administrative, procedurale e bashkive, në mënyrë që në vitin 2030, kur ne të jemi vend anëtar, të kemi bashki që të jenë të afta të punojnë me atë nivel funksionimi. Kjo është një dritare që ne nuk mund ta humbasim, sepse nuk humbasim thjesht 6 muaj, humbasim 10 vjet. Çfarë kemi parë në rastin e Kroacisë, Rumanisë, Bullgarisë, vende të ngjashme me ne, kur janë futur në BE u janë dashur 10-12 bashkive të atyre territoreve që të kenë mundësi të absorbojnë financimet e BE-së dhe u është dashur shumë kohë të përgatiten.

Ne e kemi parë rrugën e tyre, ndaj nuk kemi pse të marrim 10-12 vjet që të përgatitemi, kur mund t'i dalim kësaj pune përpara dhe të kemi mundësi që bashkitë tona, rajonet tona, territori ynë të përfitojnë siç duhet nga anëtarësia e Shqipërisë në BE.

Teksa procesi i negociimit ka punën e vet, pa dyshim, me rolin e Parlamentit; pa dyshim ka ndryshime institucionale, që ndodhin në nivel qeverie ,në nivel agjencish, në nivel legjislativ, është e rëndësishme që edhe pushteti vendor të adaptohet dhe axhustohet me këtë ngjarje, që është duke ndodhur, që është epokale në ndryshimin se si do të qeveriste vendi.

Kjo është një dritare, që është përtej gjërave që ne duhet të diskutojmë, detyra që ne kemi është të axhustohemi në raport me këtë dritare. Kjo kërkon disa gjëra të caktuara, së pari, mirëbesimin mes palëve, sepse duhet të kuptojmë që është diçka për të mirën e atdheut, për të

mirën e qytetarëve në të gjithë vendin, për të mirën e mënyrës se si qeveriset pushteti vendor jo në 5 vjet, por në 20-40 apo 50 vjetët e ardhshëm. Është shumë e rëndësishme që ne në këta 6 muaj që kemi përpara duhet të përgatitemi për të pasur një agjendë të ngjeshur pune me konsultime publike, me konsultime me ekspertët, me konsultime me ekspertët ndërkombëtarë, dhe të bëjmë më të mirën e mundshme për detyrat që kemi.

Luçiano Boçi - Faleminderit!

Edhe unë dua të bëj një shtesë, në fjalën time nuk atakova as domosdoshmërinë e reformë territoriale, as kohën nuk i përmenda, madje i dakordësova dhe e theksova që domosdoshmëria është shumë e madhe. Prandaj zgjatja e këtyre argumenteve nuk duhet të shmangë atë që unë e thashë, mirëbesimi patjetër që duhet të jetë. Ne e kemi shprehur këtë mirëbesim. Ndoshta edhe ju e keni dhënë në mënyrat dhe format që pretendoni që është dhënë, por se si është përkthyer te ne ju e dini shumë mirë, por unë kërkoj që këtë mirëbesim, meqenëse ekziston si vullnet, edhe ju e keni, ta vulosim.

Ne jemi këtu njerëz me funksion politik të plotë, marrim vendimin: po, ne do të kemi një produkt konsensual, një produkt, sepse nuk na e justifikon as koha, as domosdoshmëria që të kemi një vendim të njëanshëm. Në atë domosdoshmëri ajo që më tërheq më shumë dhe më detyron më shumë është ofrimi i shërbimit për qytetarin, pastaj pjesa e dakordësive të zbukuruara qëndron si argument, por nuk është shtysa kryesore.

Unë jam shumë dakord që të bëjmë një reformë që të rezistojë 30-40 vjet, jo 10 vjet, sepse pati reagime këtu kur thashë që ka dështuar 2015-ta, por treguesi kohor është kryesori, që ka dështuar, sepse reformat duhen për 30 - 40 vjet, jo nga fjala ime, nga fjala juaj. Nuk duhen për 10 vjet, sepse po u morën për 10 vjet do të thotë që nuk kanë funksionuar.

Gjithsesi, secili ka këndvështrimin e tij dhe nuk është i detyruar të pranojë mendimin e tjetrit. Këtë gjë që po e kërkojmë, e kërkojmë në shërbim të funksionimit të komisionit, dhe nuk duam as të shtyjmë kohë, as t'i heqim domosdoshmërinë, as në fund të bëjmë sikur ta sabotojmë, siç mund të ngrihen teza dhe teori të ndryshme. Jo, ne duam të bimë dakord në kërkesat tona dhe ato objektiva që ju i paraqisni të tilla, ne i kemi kërkesat më të thjeshta në raport me qytetarin dhe shërbimet që duhet të ketë ai. Pra, të ndërtojmë këtë bazë mirëbesimi, të certifikuar si bazë mirëbesimi, të mos ua lëmë lëvizjeve të kohës, dhe ta realizojmë.

Baza e besimit ndërtohet edhe duke artikuluar të vërteta. Po, është e vërtetë që ky komision nuk është mbledhur prej dy muajsh, por është e vërtetë që ne kemi pasur marrëdhënie të kushtëzuara me Parlamentin dhe nuk e fshehim fare, por është edhe e vërtetë që mbledhjet e komisionit nuk janë thirrur në bashkëdakordësi si bashkëkryetar, sepse ka një procedurë parlamentare që unë e njoh dhe ju e njihni. Një mbledhje e thirrur në mënyrë të njëanshme

instinktivisht kundërshtohet, sepse nuk respekton rregullin elementar të komunikimit. Tani është bërë, dhe në fakt nuk duhet ta kishit bërë është tjetër gjë, por jo këtë 2-mujorsh të na e atashoni të gjithë, duke shmangur pjesën e përgjegjësise, sepse duke thënë të vërtetat shërohem, është postulat: e vërteta shëron, dhe mbi bazën e kësaj ejani të ndërtojmë besimin, që është i domosdoshëm për produktin final.

Arbjan Mazniku - Çështjen e mirëbesimit nuk po e komentoj.

Xhelal Mziu - Së pari, ne jemi një komision i posaçëm me bashkëkryetar dhe shoh që zoti Mazniku e konsideron veten sikur jemi në një komision të përhershëm dhe merr të gjithë autoritetin e drejtimit, madje kalon dhe te rendi i ditës. Ne sot jemi mbledhur në një komision, nuk kemi dokumentet e nevojshme, pavarësisht se ka një agjendë. Ja tani pamë që kishte një material, dhe kjo ishte e paprecedentë. Ju dolët te një propozim për sekretar, në një kohë kur ne jemi në kushte të barabarta. Nuk besoj se një bashkëkryetar mund të bëjë propozimin kur votat e njëjës anë janë të pamjaftueshme për të zgjedhur. Do të ishte absolutisht normale që sekretari të zgjidhej nga opozita, sepse besoj se i keni të mjaftueshme ato 83 mandate, që janë me vota të vjedhura, apo keni edhe shumë instrumente të tjera.

Do të ishte luks nëse Jorida Tabaku të ishte sekretare e komisionit, për të treguar që ju jeni realisht të prirur për të respektuar marrëdhënien me gjysmën e komisionit...

Së dyti, duke marrë shkas nga e gjithë kjo periudhë, pra që kur janë ngritur dy komisionet, shohim se opinioni publik ushqehet në mënyrë krejt anormale nga bashkëkryetari, zoti Mazniku, duke dalë nëpër media. Së bashku me zotin Mazniku, nuk ngurron të dalë edhe kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, pavarësisht se nuk ka asnjë lidhje me funksionimin e pushtetit vendor, por nuk mjaftohet vetëm me kaq, edhe ministri pa portofol i pushtetit vendor. Në një kohë kur e gjithë bota thotë se pushteti vendor duhet të decentralizohet, Mazniku, Balla apo ministri pa portofol mbarsin opinionin publik se kauza për të shkuar në Bashkimin Europian është zvogëlimi i numrit të bashkive ose centralizimi i tyre, madje, dilet edhe përtej kësaj, duke i konsideruar si sh.p.k. fitimpruese dhe jofitimprurëse. Pushteti vendor nuk është fitimprurës, por është i vetmi instrument për t'ua ofruar sa më afër shërbimin qytetarëve.

Kjo reformë territoriale dështoi, sepse, për atë çfarë pati si kauzë, ofrimin e shërbimit, që në vitin 2014 pati një bojkot nga opozita, pasi kishte një qasje totalisht kundër decentralizimit për të ofruar shërbimin. Si pasojë, edhe ju vetë sot e deklaroni se kjo reformë 10-vjeçare ka dështuar, ndërkohë që nëpër media thoni se duhet ta thellojmë akoma më tej, për të shkuar te një produkt ose te një numër shumë herë më i pakët, në dallim me vendet e Bashkimit Europian. Ju sapo mbyllët një ligjëratë dhe thatë se ne duhet të shkojmë drejt

vendeve të Bashkimit European. Nëse ne duhet të shkojmë drejt vendeve të Bashkimit European, pse nuk marrim eksperiencën e atyre vendeve për mënyrën se si funksionon pushteti vendor, ku është qytetari ai që vendos, nëse duhet bashkuar apo duhet rritur numri i qytetarëve?!

Mjafton të shohësh numrin e banorëve për njësi vendore, të cilin sot e kemi katër herë më pak banorë për bashki, por, nëse u referohemi vetëm banorëve që janë në Shqipëri, nëse u referohemi atyre që i keni larguar gjatë këtyre viteve i bie të kemi 7 herë më shumë banorë për njësi vendore.

Pra, duhet të ndryshojë qasja. Por ajo që është më kryesorja, ju nuk mundeni ta përcaktoni se cili duhet të jetë standardi i pushtetit vendor në fillësë të këtij komisioni, pa marrë në konsideratë mendimin e ekspertëve, pa marrë në konsideratë standardin e kësaj periudhe me periudhën më parë, si dhe pa marrë si referencë vende të Bashkimit European.

Arbjan Mazniku – Përpara se t’ia jap fjalën zotit Klosi, dua të them diçka.

Zoti Mziu, ju jap fjalën për një gjë: nuk do t’ju kërkoj asnjëherë të merrni leje tek unë për të pasur një opinion për mënyrën se si duhet të funksionojë reforma territoriale, keni të drejtën të keni opinionin tuaj, pasi këtë jua japin ligji, Kushtetuta dhe qytetaria, por kërkoj të njëjtën gjë nga ana juaj. Pra, unë opinionin tim e kam dhe do ta jap aty ku e shoh të arsyeshme dhe sa herë e shoh të arsyeshme. Kjo është marrëveshja që do të bëjmë: ti do të japësh opinionin tënd dhe unë do të jap opinionin tim.

Blendi Klosi – Do të doja edhe unë ta përshëndesja këtë mbledhje të shumëpritur nga të gjithë, për t’i dhënë rrugë funksionimit të këtij komisioni, pasi realisht mendoj se duhet ta themi në çdo moment, që koha që kemi në dispozicion, si komision i posaçëm, është shumë e shkurtër. Pra, ne duhet të kemi një rezultat për një pjesë të punës sonë, që është ky sesion parlamentar, për të dhënë mundësinë që gara e ardhshme elektorale, e përgatitur për pranverën e vitit 2027, të ketë konture të dakordësuara të pushtetit vendor. Në solemnitetin e këtij konsensusi, edhe unë i bashkohem qëndrimit tuaj, zoti Mazniku, që të mos bëj komente sa u përket atyre çfarë sjell opozita në këtë diskutim. Le t’i hapim rrugë këtij komisioni.

Dua të bëj një gjysmë komenti, nëse më lejohet. Do të ishte shumë mirë që ky komision të jetë një model në lidhje edhe me atë që tha zoti Boçi, i cili foli për mungesën e dialogut në Parlament dhe për mungesën e gjetjes së gjuhës, pra ne, gra dhe burra në këtë komision, mund të dëshmojmë që, po, në raste konkrete, për gjëra konkrete, për gjëra që janë në funksion të Shqipërisë të gjejmë gjuhën e përbashkët. Kjo do të ishte një gjë fantastike dhe një mesazh i jashtëzakonshëm!

Thënë të gjitha këto, pra duke mos dashur të bëj asnjë koment për qëndrimin, do të doja të kundërshtoja një gjë në mënyrë kategorike. Reforma e realizuar, e vitit 2015, të paktën, siç po e thotë gjithsecili qëndrimin individual, është nga kryereformat e Shqipërisë dhe ka sjellë rezultate të jashtëzakonshme në mirëqeverisjen e Shqipërisë.

Po vijmë në emergjencën e realizimit të këtij komisioni për ato arsye që thatë ju, pra për të riparë efektet e reformës së vitit 2015, për të punuar fort për një gjë që nuk arritëm dot ta bënim (unë kam qenë anëtar i atij komisioni, nuk e di ndoshta edhe zoti Dule ka qenë me mua në atë komision në vitin 2015), pra që të kishim mundësinë të realizonim një hap përpara, siç ishte reduktimi i komunave dhe i bashkive, por nuk ia dolëm të kishim një dakordësi për funksionimin ashtu siç duhet të pushtetit lokal.

Qëndrimi që ju keni shprehur për të rritur pavarësinë e pushtetit vendor, forcën që ai ka nëpërmjet decentralizimit, do të duhet të jetë produkt përsëri i komisionit tonë, produkt i cili duhet të jetë sa më konsensual.

E përshëndes funksionimin e këtij komisioni, por rezervoj të drejtën për të thënë se komenti i kolegut Mziu është një qëndrim i tyre sa i përket reformës së vitit 2015, pasi është vështirë që ne të gjejmë konsensus, edhe po gjetëm një hartë të përbashkët, siç e kërkoi zoti Boçi, apo ligje të miratuara me 140 mandate, dhe vështirë të gjejmë opinione të përbashkëta për qasje të caktuara. Atë le ta gjykojnë votuesit, dhe ne le të bëjmë punën tonë, atë për të cilën jemi mbledhur.

Edhe një herë, po ju them se e mirëpresim prezencën e kolegëve këtu dhe do të ishte shumë e mirë që ky komision të jetë modeli se edhe në politikën shqiptare funksionon konsensusi.

Luçiano Boçi – Zoti Dule, fjala për ju.

Vangjel Dule – Të nderuar bashkëkryetarë, kam një këshillë miqësore, sepse bashkëdrejtimi ka një tundim, thotë përvoja: monopolizimin prej bashkëkryetarëve. Shmanguni këtij tundimi, sepse nuk jeni të detyruar të komentoni apo t'u përgjigjeni çdo kolegu, anëtar i komisionit.

Unë do të dëshiroja t'i besoja vizonit makro të paraqitur nga bashkëkryetari Mazniku, veçse ma përgënjeshton përvoja e deritanishme. Tani u kujtua Partia Socialiste se duhet të konsolidohet pushteti vendor në prag të hapave të mëtejshëm të integritimit në Bashkimin Europian?! Para dy vjetësh, me propozim të opozitës, a nuk u ngrit një komision analog për reformën territoriale dhe nga ana e Partisë Socialiste kishte vetëm negativizëm? Tashmë u kujtuat se duhet t'i rikthehemi reformës territoriale?! Por, më mirë vonë se kurrë, ja ku jemi! Por kjo nuk mund të bëhet me shantazhim. Komisioni i posaçëm reflekton disa parime

funksionimi në vendimin e seancës plenare. Çfarë mirëbesimi krijoni ju, kur në pengesën më të vogël, e cila në jetën parlamentare është më se normale, që nga Kongresi dhe Senati Amerikan e deri te parlamenti i vendit me demokracinë më të pazhvilluar, i riktheheni shantazhit se do të rishikoni përbërjen dhe mënyrën e vendimmarrjes?! Është paritet ky? Mund të funksionojë, si shpata e Demokleut, projektvendimi që keni dhe nuk e keni tërhequr akoma? Prandaj, do t'ju lutesha për më shumë sinqeritet, sepse ky nuk është moral, ky është thjesht mirëbesim ndërmjet kolegëve, pavarësisht kampit partiak, të cilët bashkërisht i futen një ndërmarrjeje të tillë shumë të rëndësishme legjislative. Prandaj, si hap i parë, tërhiqeni zyrtarisht nga programi i Kuvendit atë projektvendim.

Një çështje tjetër. Duke kaluar sërish te komisioni i legjislaturës së kaluar, bëra një propozim dhe krijova përshtypjen se u mirëkuptova prej jush. A ka mundësi që të kemi përpara nesh të paktën, në mos procesverbalet e mbledhjeve të atij komisioni, raportet përfundimtare të të dyja palëve, sepse përfundoi me dy raporte. Do të jetë një bazë e mirë nisjeje e këtij dialogu, i cili, me sa duket, do të jetë i gjatë, por besoj të jetë rezultativ.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Zoti Dule, keni shumë të drejtë sa i takon pjesës së monopolizimit, pra që duhet t'i kthejmë përgjigje secilit, e kam për detyrë t'u kthej dy përgjigje të vogla.

Së pari, sa i përket pjesës së dytë, që t'i vihen në dispozicion komisionit dokumentet, jo vetëm të komisionit të viteve 2020 dhe 2022, por edhe të vitit 2014, duhet të fillojë të punojë grupi teknik i ekspertëve (sepse kishte ngelur vetëm që të shkoja unë, dhe pastaj mund të quhet prapë monopolizim që shkova unë në arkiv për t'i marrë që t'jua vija në dispozicion, sepse nuk është detyrë e bashkëkryetarit, duhet t'i thosha Luçit, që të shkonim t'i merrnim bashkë të dy në arkiv dhe t'i sillnim), sepse, duke i vënë ekspertët në punë, ata do t'i merrnin materialet dhe do të krijonin edhe një *database* informacioni për ta ndarë. Hapi i parë, për të shkuar te hapi që kërkuat ju, me shumë të drejtë, i cili na duhet të gjithëve, është pika e tretë që kemi në rendin e ditës: miratimi i grupit të ekspertëve. Pra, duhet të fillojë punën grupi i ekspertëve dhe ne t'ia japim si detyrë, që më pas ata të na i sjellin në takimin e radhës.

Ky ishte i vetmi koment që kisha sa i takon mundësisë që të fillojmë të punojmë.

Luçiano Boçi – Zoti Gjicknuri, fjala për ju.

Damian Gjicknuri – Faleminderit, bashkëdrejtues!

Në fakt, besoj se duhet t'ia kurseni vetes këtë debat të kotë, pasi rifilluam edhe një herë punën e komisionit. Nuk është se nuk vlen debati, mos më keqkuptoni. Unë e kuptoj se ndonjëherë prezenca e kamerave... e kam thënë shpeshherë që ndonjëherë mbledhjet e komisioneve të punës, pra të këtij karakteri, do të ishin më mirë pa media. Nuk dua ta censuroj

transparencën, por ndonjëherë do të ishte më mirë që komisioni të jetë komision pune, me punë dhe propozime konkrete.

Sot jemi mbledhur për të miratuar kalendarin. Mendoj se është superuar shqetësimi, të cilin e ngriti edhe zoti Dule, që mazhoranca reflektoi. Shumë mirë që jemi në këtë pikë, pra duke zhvilluar mbledhjen, nuk besoj se ka pasur një vullnet nga ana jonë, por për shkak të ngeljes, për ato arsye politike që ju i keni bërë me dije (nuk dua t'i përsëris), një iniciativë duhej marrë, por e rëndësishme është që jemi në këtë tavolinë. Këtu kemi një kalendar, prandaj po t'ju pyes: a keni ndonjë propozim për ndryshime në metodologji? A ka ndonjë element që nuk shkon? Unë besoj se bashkëkryetari socialist, por edhe bashkëkryetari tjetër do të jetë dakord, që të gjitha materialet e reformës së kaluar duhet të na vihen në dispozicion, edhe pikëpamjet që kanë pasur ekspertët dhe palët atëherë. Nuk duhet ta marrim të mirëqenë, sepse (personalisht nuk dua ta shfaq se cili është opinionimi im, atë do ta them kur të jetë momenti), pavarësisht se ne përfaqësojmë forca politike, jo domosdoshmërisht është thënë se ne do të krijojmë pak bashki, do të mbyllet këto dhe do të shkrihen këtu, por të bëhet një diskutim se si do të delegohen kompetencat, çfarë funksionesh do të kenë, a do të kemi një hartë të re, çfarë nivele qeverisjesh do të ketë, pra janë ende shumë tema në diskutim, që ne nuk mund t'i paragjykojmë. Ju niseni nga supozimi sikur mazhoranca do të shkrijë bashkitë dhe ju doni t'i shtoni, kështu e kam kuptuar unë, por besoj se kështu e kuptojnë edhe të tjerët. Unë nuk dua ta çojmë në këtë pikë, pra nuk kemi pse të pozicionohemi akoma këtu.

Përtej anës politike, sepse e kuptoj që ky është komision vërtet i natyrës politike, ka edhe deklarata politike, këtu kemi një agjendë pune, temat janë të qarta, edhe unë jam shumë i interesuar të di premisat nga u nis reforma në atë kohë, sepse nuk kam qenë pjesë e atij komisioni. Neve na duket sikur është mbledhja e parë, sepse e njëjta gjë u tha edhe në mbledhjen e parë, një pjesë thanë se reforma ka dështuar, ne thamë se nuk ka dështuar, por ka nevojë për reflektim e të tjera. Këto janë semantika, këndvështrime, sepse çdo gjë mund të jetë edhe e mirë, edhe e keqe, disa gjëra mund të kenë ecur mirë, por disa gjëra nuk shkojnë mirë dhe kjo është krejt normale. 10 vjet është një kohë më se e mjaftueshme për të riparë një politikë; për 20 vjet amortizohet godina, kështu që për 10 vjet politika publike duhet të rishikohet. Është gjëja më normale që pas 10 vjetësh ne t'i kthehemi dhe të bëjmë një hulumtim se ku jemi dhe çfarë ndryshimesh duhet të bëjmë, duke u nisur nga demografia dhe shumë elemente të tjera që i përmendën bashkëkryetarët.

Unë do të doja, për të na kuptuar edhe njerëzit, sepse sot është mbledhja e parë e vërtetë e punës, pra kemi një agjendë pune, një program, një ndarje punësh, të kemi një prekje të territorit. Këtë e kërkoj edhe unë me shumë të drejtë, duke mbështetur edhe zotin Dule, që çdo

informacion që keni në lidhje me atë komision, të na vihet në dispozicion, ndoshta në mënyrë të përmbledhur nga ekspertët, për të na nxjerrë në pah pikëpamjet, motivet dhe racionalin pse u arrit në atë konkluzion dhe çfarë pikëpamjesh të kundërta ka pasur opozita e asaj kohe dhe që ne nuk gjetëm dakordësi. Pse jo, në njëfarë mënyre, të kthehemi tek ajo që ka qenë shqetësim edhe i asaj kohe për të rifilluar një *reset* tjetër sa i përket reformës territoriale.

E përgëzoj grupin që është marrë, agjenda është shumë konkrete dhe besoj se nuk ia vlen të debatojmë gjatë, sepse duhet të fillojmë punë, se nuk ka shumë kohë.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Fjala për zotin Haxhinasto.

Edmond Haxhinasto – Faleminderit, zoti Mazniku!

Unë dëshiroj të përsëris nevojën se duhet të jemi shumë të qartë për premisat e kësaj reforme. Pa diskutim që kemi qëndrime të caktuara politike për suksesin ose jo të reformës së mëparshme, por mendoj se këto duhet të qëndrojnë vetëm te niveli deklarativ, sepse, sa më shpejt të futemi në substancën reale të problematikës, aq më të frytshëm do të jemi në punën tonë. Mendoj se nuk ndajmë, në asnjë rrethanë, përshtypjen se ka qenë një reformë e shkëlqyer, pasi pasojat e saj patjetër që janë evidente në performancën e vendit në përgjithësi.

Gjithashtu, duhet të kemi parasysh se asnjë reformë, qoftë edhe ajo territoriale, nuk funksionon në një ekosistem të vetin, të pavarur, por funksionon në një kuadër më të gjerë dhe këtë përjasje, patjetër, duhet ta kemi. Ndonjëherë është kontributore pozitive, ndonjëherë viktimizohet nga konteksti më i gjerë politik dhe për këtë duhet të jemi pa diskutim të qartë.

Sot, së bashku me disa kolegë të tjerë, nga të dy krahët e kësaj tryeze, ishim në një takim, ku u bë një analizë shumë serioze e reformës së mëparshme. Mendoj se ajo analizë duhet t'i vihet në dispozicion çdo anëtarit të këtij komisioni, pasi ishte një përpjekje shumë serioze për një analizë jopolitike, do të thosha racionale. Një nga gjërat më të rëndësishme që na dha takimi i sotëm, i organizuar edhe nga partnerë europianë, është që të përpiqemi ta shohim këtë reformë edhe në kuadër të detyrimeve të jashtëzakonshme që ka pushteti vendor për integrimin e Shqipërisë në BE. Besoj se niveli qendror ka një detyrim dhe një borxh shumë të madh ndaj nivelit vendor sa i takon akomodimit të gatishmërisë dhe të ekzigjencave të tyre për integrimin europian.

Në mbledhjen e parë ne kemi folur për këtë dhe, duke qenë se 70% e legjislacionit i takon pushtetit vendor, mendoj se kjo çështje, pa diskutim, duhet trajtuar me shpejtësi të madhe, meqenëse ka edhe një agjendë të integritit të vendit në Bashkimin Europian.

Të futemi sa më shpejt që të jetë e mundur në racionalitetin e problematikës, si dhe të kërkojmë kontributet dhe inputet e faktorëve të tjerë shumë të rëndësishëm. Unë jam dakord

që të angazhohet edhe Kongresi i Autoriteteve Vendore. Po e theksoj edhe një herë që analizën e sotme t'ua vëmë në dispozicion të gjithë anëtarëve të këtij komisioni dhe, pa diskutim, qëndrimi politik për një ritëm të ri dhe me mirëbesim nga të dy krahët të jetë një nga gjërat e para për të cilën do të kemi konsensus dhe do ta adoptojmë.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Faleminderit, zoti Haxhinasto!

Do ta ftoja komisionin që të kthehem në pjesën praktike të rendit të ditës, duke shqyrtuar pikën e dytë, projektvendimin për caktimin e sekretarit të Komisionit. Në fakt, edhe për çështje të traditës parlamentare dhe se si ka funksionuar, pa dyshim, edhe për numrat që Parlamenti ka, sekretari është autorizim i mazhorancës.

Në mënyrë që funksionimi të kalojë në hapat e tjerë, do të doja ta kaloja këtë pikë në votim, që ta bëjmë formal dhe të kalojmë në pikat e tjera.

Luçiano Boçi – Dakord jemi që ta diskutojmë, por votimin ta zhvillojmë në fund fare.

Arbjan Mazniku – Ky ishte diskutimi dhe nuk ka diskutim përtej kësaj çështjeje.

Një pikë tjetër është miratimi i planit të punës së kalendarit të komisionit, ku në mbledhjen e parë kemi miratuar një plan paraprak pune, por, duke qenë se komisioni nuk pati aktivitet për një periudhë kohe, në thelb kalendarit i ri është rishikim, por me kohë pak më të ngjeshur, duke tentuar që të mbajmë të njëjtin objektivi. Jam i gatshëm që të bëj një prezantim të shkurtër të pikave të kalendarit. Nuk ka ndryshim në hapa kyçë nga dokumenti paraprak që ne kemi miratuar në mbledhjen e datës 11, por, duke qenë se një seri gjërash që i kishim për t'i zhvilluar gjatë muajit dhjetor apo janar nuk kanë ndodhur, thjesht i kemi ngjeshur deri diku agjendat. Në bisedat që kam bërë paraprakisht me bashkëkryetarin, kuptova se anëtarët e komisionit nuk duan ta miratojnë sot në mënyrë formale kalendarin, që të kenë mundësi të njihen më shumë me të. Ndaj, do të doja shkurtimisht t'jua prezantoj se si janë menduar nga ana jonë hapat e mëtejshëm, më pas, siç folëm edhe me bashkëkryetarin, të bëjmë nesër një takim gjatë seancës për ta miratuar, në mënyrë që nga aty në mënyrë të mirëfilltë të fillojmë planin e punës.

Luçiano Boçi – Mendoj dhe kërkova që edhe paraqitja e planit të punës të bëhet në të njëjtën ditë që bëhet edhe votimi, por, meqenëse për të fituar kohë na duhet të mblidhemi nesër përgjatë seancës, propozimi ynë është: paraqitja dhe oponenca, oponencë në kuptimin e propozimeve të tjera shtesë, të bëhet ditën e nesërme, sepse është kërkesë e dakordësuar. Sot është e pamundur ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, t'i dëgjojmë edhe anëtarët e tjerë të komisionit.

Të dyja datat janë të përshtatshme, si dita e enjte, edhe dita e premte. E vendosim bashkë.

Arbjan Mazniku – Fjala për zonjën Tabaku.

Jorida Tabaku – Faleminderit, zoti bashkëkryetar!

Pa dashur të përsëris veten, sepse ne e zhvilluam një mbledhje të parë dhe i diskutuam qëndrimet tona për reformën, mendoj se ka ardhur koha të lëvizim dhe të punojmë. Ky dokument pune që ju keni prezantuar, është një variant më i zgjeruar i asaj që ne diskutuam herën e shkuar. Unë gjykoj që dy bashkëkryetarët duhej ta kishin propozuar së bashku këtë dokument, sepse, edhe në kuadër të diskutimeve që zhvilluam këtu, produktet, për të cilat do të jemi dakord bashkë, nisur që nga plani i punës dhe duke vijuar në dokumentet e tjera, duhet të vijmë si një propozim i përbashkët.

Nesër është seanca parlamentare dhe duam të japim komentet dhe propozimet tona për këtë plan pune. Propozimi ynë është për ditën e hënë një mbledhje, por, nëse ju doni ta zhvillojmë të premten, është një ditë më e mirë se nesër. Por që të jetë një produkt i përbashkët, ne kemi nevojë që secili nga ne të japë një koment për këtë. Duhet të kemi parasysh që puna e komisionit sot rifilloi. Që nga ky moment nuk ka asnjë bllokim pune, pra që në këtë moment për çdo procedurë tjetër, me emërimin e ekspertëve dhe më pas të sekretarit, gjërat të fillojnë dhe lëvizin, por ne kemi nevojë, edhe në kuadër të atij besimi që u përmend, të jetë një produkt i përbashkët; kemi nevojë të japim komentet tona dhe të reflektojmë sugjerimet që ne kemi.

Faleminderit!

Enno Bozdo – Në vazhdim të asaj që tha zonja Tabaku, ky është një dokument i rëndësishëm për të organizuar punën. Sinqerisht, nuk kam pasur mundësi as t'i hedh një sy, sepse nuk më ka ardhur as me *email*...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, tani ka ardhur. Mendoj se duhet ta shikojë secili nga ne, të ulemi me njëri-tjetrin, më pas të vijmë. Kjo nuk bëhet me qëllimin për ta shtyrë, por është dokumenti mbi të cilin do ta bazojmë të gjithë punën. Nëse marrim dy ditë sot, ne mund t'ia kursejmë vetes shumë gjëra në të ardhmen. Kështu që, nëse e keni të mundur...

Arbjan Mazniku – Nuk kam asnjë problem me shtyrjen edhe dy ditë të tjera. Kam bërë një bisedë paraprake me kryetarin, kur dakordësuam datën për gjërat që donim të diskutonim në këtë mbledhje. Pra, qëkur diskutuam ditën e mbledhjes së sotme, bëra një bisedë paraprake me bashkëkryetarin për të diskutuar temat e përgjithshme. Elementi thelbësor në këtë çështje

ka të bëjë me dy momentet e konsultimeve publike, të cilat janë pjesë e dokumentit. Po i ndaj thjesht për opinion dhe nuk kam asnjë problem që ne t'i miratojmë këto të hënën. Propozimi është që komisioni të ndahet në tri nëngrupe pune dhe secili nëngrup të mbulojë 4 qarqe që të kemi mundësi që në një periudhë 2 apo 3-javore të shkojmë fizikisht në qarqet respektive dhe të bëjmë diskutime me pushtetin vendor, me këshillin bashkiak, me këshillin e qarqeve, me biznesin lokal, pra të bëjmë diskutime në terren, për të pasur mundësi që brenda muajit shkurt apo javën e parë të marsit të mbyllim procesin e konsultimeve në terren për të shpenzuar më pas fazën e dytë gjatë muajit mars dhe një pjesë të muajit prill për konsultime tematike, që do të ndodhin këtu, sipas fushave respektive, tematike, territori, kompetencat, financat publike. Kjo çështje, sigurisht, vlen të diskutohet dhe pa dyshim që do të ishte e mirëpritur të kemi input. Por, duke pasur parasysh komentin shumë të drejtë të zonjës Tabaku që duhet të fillojmë të punojmë dhe të lëvizim, do të doja që çdo ditë të dalim në terren dhe të bëjmë takime në territor, nga dita e enjte apo premtja në të hënën, sigurisht, nuk ndryshon gjë, ditët që duhet t'i rikuperojmë më pas... Për sa kohë biem dakord që ditën e hënën të bëjmë një takim ku të kemi inputet dhe më pas, nëse duhet ndryshuar diçka në agjendë, ta ndryshojmë, nuk kam ndonjë problem thelbësor me këtë çështje, por merakun që kam është vetëm një: duhet të përgatitemi që në muajt shkurt dhe mars do të ketë punë të mirëfilltë dhe një pjesë e kësaj pune është në terren, pra duhet të shkojmë të bëjmë takime në terren për të biseduar me ta drejtpërdrejt.

Luçiano Boçi – Fjala për Ramadan Likaj.

Ramadan Likaj – Sigurisht, për të gjitha fjalët që thanë bashkëkryetarët, absolutisht që ne nuk jemi kundër, por jemi pro. Para se të vinim në këtë takim, ne e diskutim me kryetarin dhe dhamë sugjerimet, propozimet, komentet tona dhe thamë që duhet të kemi pak kohë që të njihemi me materialin, për të qenë të sinqertë, sepse, nëse ka një dakordësi të tillë në këtë komision, besoj se gjërat nuk besoj se prishen për dy ditë dhe do të shkojnë mirë. Ne propozuam që mbledhja të bëhet ditën e hënë, që të kemi pak kohë, pse jo, të miratohet edhe kalendari i punimeve. Për të qenë të sinqertë, ai këmbënguli disa herë, por edhe ne këmbëngulëm, sepse duhet të njihemi me materialet dhe besoj se kjo është një gjë krejt normale për këtë komision, nëse ka dakordësinë e duhur për ta vazhduar bashkëpunimin për të ardhmen.

Luçiano Boçi – Kam diçka për të shtuar.

Meqenëse bashkëkryetari nuk e mbajti tundimin për të bërë një paraqitje të shkurtër të projektkalendarit, gjithsesi i paraqitur, edhe unë nuk po e përmbaj dot tundimin tim për të bërë një kërkesë, të cilën ndoshta e kemi paradiskutuar, por duhet të jemi të përgatitur.

Takimet në terren janë fjalë të bukura, se unë e konceptoj si takim me qytetarët, nga vetë kuptimi i fjalës “terren”. E di që është shumë e vështirë dhe hapet një lojë e pafund, por

me vendet, që kanë kërkesa specifike thelbësore nga qytetarët, pavarësisht ngjyrimeve politike, duhet të jemi të gatshëm dhe të parashikojmë në kalendar takime me qytetarë të këtyre zonave, sepse, nëse i kalojmë dëgjesat vetëm në nivel të përfaqësimit të pushtetit lokal, kam frikë se qëndrimet e tyre janë ngushtësisht politike, të orientuara më parë, të paracaktuara dhe nuk do të marrim një opinion shumë real, shumë konkret. Mendoj se opinioni i marrë bruto nga njerëzit për mënyrën sesi funksionon pushteti lokal, si shkon tek ata, si i përgjigjet, si e perceptojnë ata qenien në një territor të përbashkët me një zonë që i bashkon tradita dhe historia, do të ishte më efektive për punën e komisionit. Siç e thashë, nuk është e lehtë, sepse e shton shumë agjendën e komisionit dhe nuk përballohen të gjitha kërkesat, por mendoj se në vendet e caktuara, ku ka kërkesë specifike, ne duhet të parashikojmë takime për këto çështje me qytetarët.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Jemi dakord me këtë pikë dhe e kalojmë diskutimin për ditën e hënë.

Si pikë të fundit të rendit të ditës kemi shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e emrave të ekspertëve pranë komisionit”.

Siç është diskutuar në mbledhjen paraprake, është rënë dakord që ne të kemi 4 grupe ekspertësh, ku 1 grup përbëhet nga 10 ekspertë të nivelit të lartë dhe 3 grupe ekspertësh teknikë të fushave respektive. Njëri grup merret me territorin dhe qeverisjen, grup i dytë merret me financat vendore dhe grup i tretë merret me kompetencat. Në mënyrë që ne të kemi mundësi t’i përcjellim, së bashku me bashkëkryetarin kemi dakordësuar mënyrën e ndarjes së këtyre ekspertëve, propozime që vijnë nga mazhoranca dhe opozita, ndaj do të doja dakordësinë e të gjithë komisionit që ne t’ia përcjellim listën e ekspertëve Byrosë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Votojmë për të dyja vendimet, pra vendimin për sekretarin dhe vendimin për emrat e ekspertëve.

Luçiano Boçi – Së pari, votojmë për sekretarin dhe më pas për ekspertët.

Arbjan Mazniku – Për sekretarin: propozimi i Partisë Socialiste është zoti Ermal Pacaj.

Kalojmë në votim. Pro? Kundër? Abstenim?

Vendimi miratohet.

Kalojmë në votimin e listës së emrave të ekspertëve pranë komisionit. Për informacion, lista është e pjesshme, sepse kemi rënë dakord me bashkëkryetarin që në mbledhjen e radhës do të bëjmë plotësim për ekspertët, të cilët do të dakordësohen nga të dyja palët në vijimësi.

A jeni dakord të kalojmë në votim për t'ia kaluar Byrosë?

Luçiano Boçi – Kalojmë në votim, se nuk është mësuar me komisionet.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Arbjan Mazniku – Nuk kemi çështje të tjera për diskutim.

Faleminderit! Ditë të mbarë!

Mbledhja e radhës është ditën e hënë.

MBYLLET MBLEDHJA